ОПШТИНА СТРУГА
KOMUNA E STRUGËS
Бр./Nr. 10-2629/18
04.11.20 26
СТРУГА STRUGË

ОПШТИНА СТРУГА/KOMUNA E STRUGËS

KORRIGJIM TË SHPALLJES Nr. 01/2026

Për tjetërsimin e tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të ankandit publik elektronik në KK Strugë

Kryhet korrigjim të shpalljes për tjetërsimin e tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të ankandit publik elektronik me qëllim A1-Banim në shtëpi banimi në KK Strugë, e publikuar në G.zyrtare të RMV nr.254/26 të datës 30.10.2026, Gazeta "Koha" në datë 28.10.2026, Gazeta "Veçer" në datë 28.10.2026 dhe Gazeta "Nova Makedonija" në datë 28.10.2026, dhe atë:

Në pjesën "LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK",

Në pasqyrën tabelare të shpalljes në kolonën për parcelën ndërtimore **2.03 me qëllim A1-Banim në shtëpi banimi** "Çmimi fillestar i përcaktuar për metër katror (denarë)" ndryshohet dhe është siç vijon:

"Çmimi fillestar për m2 (denarë) në ankandin publik elektronik për parcelën ndërtimore **2.03** me qëllim A-Banim në shtëpi banimi e shënuar në pasqyrën tabelare **kap shumën 61,oo denarë** për metër katror".

Në pasqyrën tabelare të shpalljes në kolonën për parcelën ndërtimore **2.03** me qëllim A1 -Banim në shtëpi banimi pjesa "Gjithsej çmimi i përcaktuar" ndryshohet dhe është siç vijon:

"Gjithsej çmimi i përcaktuar në ankandin publik elektronik për parcelën ndërtimore **2.03** e shënuar në pasqyrën tabelare kap shumën **24.827,oo denarë"**

Në pasqyrën e shpalljes në kolonën për parcelën ndërtimore **2.03 me qëllim A1-Banim në shtëpi banimi** "Garancioni bankar për seriozitet të ofertës " ndryshohet dhe është siç vijon:

"Garancioni bankar për seriozitet të ofertës në ankandin publik elektronik për parcelën ndërtimore **nr.2.03** e shënuar në pasqyrën tabelare kap shumën **124.135,oo denarë**".

Në pjesën "KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK" pika 2 ndryshohet dhe thuhet:

" Garancioni bankar për seriozitet të ofertës në shumë prej 500% nga çmimi i përgjithshëm i parcelës ndërtimore të përcaktuar në pajtim me pasqyrën tabelare ne veçanti dhe atë për **p.n.2.03 kap shumën prej 124.135,oo denarë në afat afat vlefshmërie deri më 28.02.2027".**

Në pjesën "**ÇMIMI FILLESTAR**" për parcelën ndërtimore **2.03** ndryshohet dhe është siç vijon:

"Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcelën ndërtimore **2.03** të shënuar në pasqyrën tabelare kap shumën **61,oo denarë për metër katror".**

Në pjesën "**PROCEDURA "** pika 6 ndryshohet dhe thuhet:

"Ankandi kryhet në bazë të "hapit" me rritjen e vlerës me secilin hap, i cili kap shumën jo më pak se 10% nga çmimi fillestar minimal, respektivisht vlera në secilin "hap" kap shumën **200,oo denarë për metër katror** për parcelën ndërtimore **2.03** të përcaktuar në pasqyrën tabelare.

Në pjesën e mbetur të dhënat e Shpalljes mbeten të pandryshuara.

KOMUNA E STRUGËS

Komisioni për zbatimin e procedurave për

ankand publik

Resul Hani- Kryetar